

VENDIM
Nr. 504, datë 29.8.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 811, DATË 29.12.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “Për MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2018, PËR ZYRËN E
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 13, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, dhe të nenit 29, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


Në vendimin nr. 811, datë 29.12.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shtojca nr. 1, e përmendur në pikën 1, ndryshohet dhe zëvendësohet me shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Shtojcat nr. 2 dhe nr. 3, të përmendura në pikën 2, ndryshohen dhe zëvendësohen me shtojcat nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**PEMA E PROGRAMIT TË ZRPP E NDRYSHUAR PËR
VITIN 2018**

SHTOJCA 1



SHTOJCA 2

Në 000/ lekë

BUXHETI 2018 I NDRYSHUAR		
Përshkrimi	Buxheti 2018 i ndryshuar	
	Të ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Të ardhura nga shërbimet	2,791,816	
Shpenzime personeli		858,754
Shpenzime korrente		458,333
Investime		886,311
Fondi rezervë		104,700
Fonde të ngrira		483,718
Totali	2,791,816	2,791,816
Teprica (1)-(2)		0

SHTOJCA 3**BUXHETI I VITIT 2018 I NDRYSHUAR***Në 000/ lekë*

Nr.	EMËRTIMI	Buxheti 2018 i ndryshuar
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	2,791,816
	Të ardhura nga tarifat e shërbimeve	1,634,458
	Fonde që parashikohet të trashëgohen nga viti 2017	1,052,657
	Fond rezervë i trashëguar	104,700
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	2,791,816
1	Shpenzime personeli	858,754
	Paga	710,801
	Kontribute për sigurime shoqërore	117,990
	Fondi i veçantë i pagave	29,963
2	Shpenzime operative	458,333
	Shpenzime të mirëmbajtjes e të tjera	458,333
3	Shpenzime kapitale	886,311
	Investime kapitale të brendshme	886,311
4	Fondi rezervë	104,700
	Fondi rezervë	104700
5	Fonde të ngrira	483,718
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME	0